

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari **Jonuz Bugari**, si kryetar i trupit gjykues, gjyqtarëve porot: **Aliriza Sokoli** dhe **Mustafë Cena**, anëtar të trupit gjykues, me bashkëpunëtorin profesional **Armond Omega**, në çështjen juridike të propozueses N. S. U. e lindur në Bucuresti – Rumani, tani me vendbanim në Gjermani, të cilin e përfaqëson përfaqësuesi i saj i autorizuar Q. Q. avokat nga Rahoveci, sipas autorizimit në shkresat të lëndës, dhe propozuesit R. M. nga fshati G., Komuna e Rahovecit, për shkak të zgjidhjes së martesës me marrëveshje, pas mbajtjes dhe përfundimit të seancës së shqyrtimit kryesor jo publik, zbatimit të provave, pas këshillimit dhe votimit, më **21.11.2018**, morri këtë:

A K T G J Y K I M

ZGJIDHET ME MARRËVESHJE martesë në mes të propozueses **N. S. U.** lindur më ..., dhe propozuesit **R. M.** i lindur më ..., martesë e lidhur më ..., në Zyrën e Gjendjes Civile në Rahovec – X., Nr. ser. **M ...**, me numër të referencës **16/2015RM/16003**, me numër rendor

Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Propozuesja N. S. U. nëpërmjet përfaqësuesit të saj të autorizuar, dhe R. M. në këtë gjykatë kanë parashtruar propozim të përbashkët për zgjidhjen e martesës me marrëveshje, kanë cekur palët ndërgjyqëse përkundër faktit që kanë lidhur martesë në aspektin formal, në Komunën e Rahovecit, kontakt të vetëm mes veti kanë pas me datën e lidhjes së martesës, dhe prej asaj date 14.04.2015, nuk kanë pas më kontakte dhe nuk kanë kriju bashkësi në kuptim të plotë të fjalës pos që kanë pas ndonjë kontakt me mjete elektronike.

Në lidhje me këtë çështje juridike gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor për datën 21.11.2018, në të cilën seancë është paraqitur përfaqësuesi i propozueses së parë avokati Q. Q., dhe propozuesi i dytë R. M. personalisht.

Propozuesi i autorizuar i propozueses së parë Avokati Q. Q. ka deklaruar se palët ndërgjyqëse kanë lidhur martesë më datë 14.04.2015, në Zyrën e Gjendjes Civile në X., dhe qëllimi i kësaj martese ka qenë që bashkëshortët formal këtu palët ndërgjyqëse të krijojnë bashkësi martesore, bashkëjetesë dhe me vullnetin e tyre edhe familje, por përkundër këtij fakti juridik, palët ndërgjyqëse në cilësitë bashkëshortëve, burë e grua nuk kanë bashkëjetuar prej vitit 2015 dhe në marrëveshje të përbashkët, sipas fjalëve të klientës së tij ata janë marrë vesh që këtë martesë formale të lidhur pranë ofiqarisë në X., ta zgjidhin me marrëveshje duke e shkurorëzuar, nga se sipas klientës së tij ka humbur kuptimi ligjor i martesës ajo jeton jashtë Kosovës, ndërsa R. M. si bashkëshortë jeton në Kosovë në fshatin G., Komuna e Rahovecit, duke marrë parasysh të cekura se sipas Ligjit për Familje neni 68 ka humbur kuptimin e martesës, për shkak të mungesës së bashkëjetesës mbi 1 vit i propozoj gjykatës që propozimin e përbashkët të palëve për zgjidhjen e martesës me marrëveshje ta miratojë si me bazë, nuk kanë fëmijë e as nuk presin lindjen e fëmijës, sa i përket shpenzimeve palët janë marrë vesh që secili të i bartë shpenzimet e veta procedurale, dhe i propozoj gjykatës që martesë të zgjidhet me marrëveshje.

Propozuesi i dytë R. M. deklaroi se ngel në tërësi pranë thëniesve të cekura në propozim të përbashkët për zgjidhjen e martesës me marrëveshje, gjithashtu i vërtetoi thëniet e përfaqësuesit të propozuesit të parë të cekura gjatë seancë, duke shtuar se në vitin 2015 kanë lidhur martesën dhe një ditë më pas kanë shkuar për Gjermani, kanë pasur kontaktet telefonike mirëpo kontaktet fizike jo, prej asaj kohe ajo jeton në Gjermani ndërsa ai në fshati G., meqenëse unë nuk kam mundur të shkojë në Gjermani dhe ajo nuk ka mundur të jetoj në Kosovë, ky është shkaku se ata nuk kanë mundur të jetojnë bashkë, nuk kanë lindur fëmijë e as që presin lindjen e fëmijës, i propozoi trupit gjykues që të miratoi propozimin e përbashkët dhe ta zgjidh bashkësinë martesore me marrëveshje.

Gjykata, për vërtetimin e plotë të gjendjes faktike ka bërë administrimin e provave dhe atë: ka bërë shikimin e certifikatës së martesës Nr. ser. M ..., me numër të referencës 16/2015RM/16003, me numër rendor ..., e lëshuar pranë Zyrës së Gjendjes Civile në Rahovec, më 28.09.2018.

Pas analizimit dhe vlerësimit të provave, në bazë të bindjes së vetë të lirë, e duke u bazuar në nenin 8 të LPK-së, është konstatuar se propozimi i përbashkët i propozuesve për zgjidhjen e martesës me marrëveshje, është i bazuar dhe i njëjti është aprovuar.

Me shikimin në certifikatën e martesës me nr. ser. M ..., e lëshuar pranë Zyrës së Gjendjes Civile në Rahovec, më 28.09.2018, vërtetohet se N. S. U. lindur më ..., dhe propozuesit R. M. i lindur më ..., kanë lidhur martesë më ..., në Zyrën e Gjendjes Civile në Rahovec.

Si fakt relevant në këtë çështje juridike gjykata muar për bazë se propozimin për zgjidhjen e martesës me marrëveshje palët e kanë bërë bashkërisht, se martesë është lidhur formalisht por nuk kanë jetuar së bashku.

Andaj në bazë të gjendjes faktike të cekur më lartë dhe duke u bazuar në dispozitat neneve 68, 69 dhe 84 të Ligjit mbi Familjen i Kosovës dhe nenit 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është mbështetur në dispozitën e nenit 450 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
C.nr. 339/2018, më 21.11.2018.

B. Profesional
Armond Qmega

Kryetari i trupit gjykues
Jonuz Bugari

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, ankesa paraqitet ndërmjet kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit Divizioni Civil në Prishtinë.